

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dytë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 30.12.2025, merr këtë:

VENDIM NR.57/2025/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 05.12.2025

Neni 1

Miratohet procesverbali nga mbledhja konstituive e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 05.12.2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja konstituive e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 05.12.2025.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.


Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević



PROCESVERBALI

Nga mbledhja konstituive e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, e mbajtur më datën 05.12.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës në Graçanicë dhe filloi me punë në orën 11:00.

Rendi i propozuar i ditës për mbledhjen konstituive:

11:00 - 11:15	Mbërritja dhe nënshkrimi i asamblistëve të Kuvendit të komunës dhe pjesëmarrësve të tjerë
11:15 - 11:30	Fjala përshëndetëse nga anëtari më i vjetër i Kuvendit të komunës ▪ Fjala e mirëseardhjes
11:30 – 11:45	Kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i vjetër i Kuvendit të komunës • Dhënia e betimit nga ana e asamblistëve të Kuvendit të komunës • Dhënia e betimit nga ana e kryetarit të komunës
11:45 – 12:00	• Fjala e mirëseardhjes nga kryetari i komunës
12:00 – 12:45	• Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të komunës
12:45	Përfundimi i mbledhjes

Anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Dejan Jevtiq, iu drejtua me një fjalë mirëseardhjeje kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq, asamblistëve të Kuvendit të komunës, si dhe përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it, MAPL-së dhe mediave. Meqenëse është konfirmuar se të gjithë 18 asamblistët janë të pranishëm në mbledhje dhe se ka kuorum, anëtari më i vjetër i Kuvendit të komunës i njoftoi të pranishmit se kryetari i Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq, ka paraqitur dorëheqje me shkrim nga pozita e asamblistit të Kuvendit të komunës për ta nënshkruar sot deklaratën solemne si kryetar i Komunës së Graçanicës.

Anëtari më i vjetër i Kuvendit të komunës, Dejan Jevtiq, i ftoi asamblastët e pranishëm të ngriheshin në këmbë dhe ta lexonin tekstin e deklaratës solemne me të:

„Unë, Milla Zhivković (*Mila Živković*), Millan Dimitrijević (*Milan Dimitrijević*), Dejan Božidarević (*Dejan Božidarević*), Sasha Mladenović (*Saša Mladenović*), Ljubisha Karaxhiq (*Ljubiša Karadžić*), Bojana Mitić (*Bojana Mitić*), Bobana Jovanović Trajković (*Bobana Jovanović Trajković*), Dejan Jevtić (*Dejan Jevtić*), Millosh Dimić (*Miloš Dimić*), Marija Stević (*Marija Stević*), Jellena Krstić (*Jelena Krstić*), Dragan Maksimović (*Dragan Maksimović*), Leutrim Ajeti, Bekim Gashi, Aida Qerkini, Lumnije Gashi, Igor Rashiq (*Igor Rašić*), Ivana Vujović (*Ivana Vujović*), deklaroj solemnisht se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë qytetarët”.

Pas dhënies së deklaratës solemne, anëtari më i vjetër i Kuvendit të komunës, Dejan Jevtiq, i ftoi asamblastët që ta nënshkruajnë individualisht deklaratën e tyre.

Pas nënshkrimit të deklaratës solemne nga ana e asamblastëve të KK të Graçanicës, anëtari më i vjetër i Kuvendit të komunës, Dejan Jevtiq, e ftoi kryetarin e Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq, ta lexojë dhe nënshkruajë deklaratën solemne.

„Unë, Novak Zhiviq, deklaroj solemnisht që do t'i kryej detyrat e mia dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i Komunës së Graçanicës me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë.”

Pas nënshkrimit të deklaratës solemne, kryetari i Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq, iu drejtua të pranishmëve me fjalët e mëposhtme: “Të dashur qytetarë, përfaqësues të nderuar të institucioneve, mysafirë të nderuar, përfaqësues të mediave, më është nder dhe kënaqësi që sot qëndroj këtu para jush duke marrë detyrën e kryetarit të ri të Komunës së Graçanicës, duke filluar kështu, së bashku me ju, një kapitull të ri në përmirësimin e qëndrueshmërisë së të gjitha komuniteteve që jetojnë në territorin e Komunës së Graçanicës. Besoj se kemi një qëllim të njëjtë, që është ta bëjmë komunën tonë më të mirë, më të qëndrueshme dhe më të rregulluar. Ky Kuvend, i cili sot e fillon punën në këtë mandat të ri, është rezultat i vullnetit të qytetarëve. Jemi këtu për ta treguar se bashkëjetesa, respekti i ndërsjellë dhe puna e përbashkët janë përditshmëria jonë, pavarësisht nga përkatësia kombëtare apo fetare dhe se kjo është e vetmja rrugë e vërtetë drejt përparimit. Të nderuar asamblastë, çdo vendim dhe çdo hap i juaj kërkon mençuri, guxim dhe, mbi të gjitha, durim. Ju ftoj, pavarësisht dallimeve politike, të punojmë së bashku në një atmosferë respekti, nderi dhe ligjshmërie, të mos lejoni që interesat personale politike ose të çdo interesi tjetër të na ndajnë. Ju ftoj në një dialog të hapur, të sqartë dhe konstruktiv si dhe të merrni pjesë aktive në marrjen e vendimeve që do ta formësojnë të ardhmen tonë të përbashkët. Të nderuara media, dua që nga ky vend t'ua përcjellni edhe një herë mesazhin qytetarëve tanë se

unë do të jem një kryetar që qëndron pranë qytetarëve të tij, një kryetar që do ta dëgjoj zërin e tyre dhe do të punoj me përkushtim në interes të të gjithëve. Mediat janë partneri ynë i fortë dhe përmes shërbimeve tona dhe unë personalisht do të jem në dispozicion për çdo informacion me rëndësi publike. Kolegë dhe kolege, ju ftoj që së bashku të vazhdojmë të punojmë me zell në fuqizimin e administratës publike dhe infrastrukturës së planifikuar, përmirësimin e shërbimeve komunale, si dhe ta respektojmë dhe vlerësojmë njëri-tjetrin. Do të jemi të hapur për të gjithë partnerët që dëshirojnë të punojmë së bashku përmes ideve, projekteve dhe mbështetjes, por edhe për të gjithë njerëzit me vullnet të mirë dhe komunat vëllazërore që e duan Graçanicën dhe ku ata janë gjithmonë të mirëpritur ngrohtësisht. Le të jetë ky Kuvend një lloj betimi për të gjithë ne për të ndërtuar, punuar dhe besuar në prosperitet, mbijetesë si dhe për të luftuar që çdo fëmijë të lindë me shpresë dhe çdo person të jetojë me dinjitet. Uroj që në këtë mandat të ri t'u shërbejmë qytetarëve me nder dhe integritet. Punë të mbarë të gjithëve!”

Anëtari më i vjetër i Kuvendit të komunës, Dejan Jevtiq, hapi pikën e radhës së rendit të ditës: Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të komunës. Ai i ftoi subjektet politike që t'i propozojnë kandidatët e tyre për kryesuesin e Kuvendit të komunës.

Asamblisti i Kuvendit të komunës, Ljubisha Karaxhiq, para partisë “Srpska”, e propozoi Millan Dimitrijeviqin për kryesues të Kuvendit, duke thënë se ky është mandati i dytë i Millan Dimitrijeviqit si kryesues i Kuvendit të komunës dhe i treti si asamblist i Kuvendit lokal. “Unë besoj se ai do të ketë durim për të gjithë asamblastët dhe se do ta udhëheqë Kuvendin më mirë se sa në mandatin e tij të mëparshëm. Ky pozicion kërkon përvojë dhe, sipas mendimit të kolegëve të mi nga “Lista Serbe”, ne besojmë se Dimitrijeviqi është personi i duhur për të”, tha Karaxhiq.

Meqenëse nuk kishte propozime të tjera, asamblisti më i vjetër i Kuvendit i ftoi asamblastët të propozojnë tre asamblastë si anëtarë të Komisionit për zgjedhjen e kryesuesit.

Asamblisti Millosh Dimiq e propozoi Dejan Bozhidareviqin.

Asamblisti Leutrim Ajeti e propozoi Bekim Gashin.

Asamblisti Dejan Jevtiq e propozoi Ivanën Vujoviq.

Asamblisti më i vjetër i Kuvendit të komunës e propozoi Ivanën Vujoviq si kryetaren e komisionit.

Asamblisti më i vjetër i Kuvendit dha një pushim pesëminutësh në mënyrë që Shërbimi për Çështjet e Kuvendit të mund ta përgatisë pjesën teknike për zgjedhjen e kryesuesit.


Pas pauzës pesëminutësh, asamblisti më i vjetër i Kuvendit të komunës i ftoi anëtarët e Komisionit për zgjedhjen e kryesuesit ta kontrollojnë materialin për votim.

Kryetarja e Komisionit për zgjedhjen e kryesuesit, Ivana Vujoviq, e ftoi secilin asamblist individualisht që të votojë duke rrethuar pro, kundër ose abstenim.

Pas votimit të fshehtë, Komisioni i numëroi votat dhe e shpalli rezultatin se Millan Dimitrijeviqi u zgjodh si kryesues i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, me 14 vota "Pro" dhe 4 vota "Abstenim".

Anëtari më i vjetër i Kuvendit


Dejan Jeytić



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, i falënderoi të gjithë asamblistët që morën pjesë në votim dhe shprehu shpresën se puna e të gjithë asamblistëve do të bazohet në interesat e qytetarëve që i zgjodhën ata. "Është një nder i madh për mua që ma keni dhënë përsëri besimin tuaj. Dua që ne të mësojmë më shumë dhe të bëjmë më shumë për të gjithë popullsinë e Komunës së Graçanicës gjatë këtij mandati, në bashkëpunim me kryetarin e Komunës së Graçanicës dhe të gjithë asamblistët. Besoj se mund të bëjmë më shumë".

Mbledhja përfundoi në orën 11:33.

Procesmbajtësi
Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević

